

No. 55250*

**Denmark
and
Albania**

Agreement between the Government of the Kingdom of Denmark and the Government of the Republic of Albania concerning the promotion and reciprocal protection of investments. Copenhagen, 5 September 1995

Entry into force: *18 January 1996 by notification, in accordance with article 15*

Authentic texts: *Albanian, Danish and English*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Denmark, 1 July 2018*

**No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.*

**Danemark
et
Albanie**

Accord entre le Gouvernement du Royaume du Danemark et le Gouvernement de la République d'Albanie relatif à la promotion et à la protection réciproque des investissements. Copenhague, 5 septembre 1995

Entrée en vigueur : *18 janvier 1996 par notification, conformément à l'article 15*

Textes authentiques : *albanais, danois et anglais*

Enregistrement auprès du Secrétariat de l'Organisation des Nations Unies : *Danemark, 1^{er} juillet 2018*

**Aucun numéro de volume n'a encore été attribué à ce dossier. Les textes disponibles qui sont reproduits ci-dessous sont les textes originaux de l'accord ou de l'action tels que soumis pour enregistrement. Par souci de clarté, leurs pages ont été numérotées. Les traductions qui accompagnent ces textes ne sont pas définitives et sont fournies uniquement à titre d'information.*

MARREVESHJE

**Midis Qeverise se Mbreterise se Danimarkes dhe Qeverise se
Republikes se Shqiperise per Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke
te Investimeve.**

Hyrje

Qeveria e Mbreterise se Danimarkes dhe Qeveria e Republikes se
Shqiperise, me poshte te referuara si Pale Kontraktuese,

Duke deshiruar te krijojne kushte te favorshme per investimet ne te
dy Shtetet dhe te intensifikojne bashkepunimin midis ndermarrjeve
ne te dy Shtetet, me qellim stimulimin e perdorimit produktiv te
burimeve,

Duke njohur qe trajtimi i drejte dhe i barabarte i investimeve mbi baza
reciproke do ti sherbeje ketij qellimi,

U moren vesh si me poshte:

NENI 1

Percaktime

Per qellime te kesaj Marreveshjeje,

(1) Termi "investim" kupton cdo lloj pasurie te investuar nga nje investitor i njeres Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese dhe do te perfshije ne vecanti, por jo ekskluzivisht:

(i) pasurite e prekshme dhe te paprekshme, te luajteshme dhe te paluajteshme, si dhe cdo te drejte tjeter pronesie si qirate, hipotekat, pengjet, kaparet, privilegjet, garancite dhe cdo e drejte tjeter e ngjashme,

(ii) nje kompani ose ndermarrje tregtare, ose aksionet, fondet ne aksione ose forma te tjera te pjesemarrjes ne nje kompani ose ndermarrje tregtare, obligacionet dhe borxhe te ngjashme te nje kompanie ose ndermarrje tregtare,

(iii) fitimi i riinvestuar, pretendimet ne para dhe pretendimet qe lindin nga zbatimi i nje kontrate qe ka nje vlere ekonomike,

(iv) te drejtat e pronesise intelektuale, duke perfshire te drejten e autorit, patentat, emrat tregtare, teknologjia, markat tregtare, deshira e mire, know-how dhe cdo e drejte tjeter e ngjashme,

(v) koncesionet dhe te drejta te tjera te referuara sipas ligjit apo nje kontrate, duke perfshire koncesionet per nxjerrjen ose shfrytezimin e burimeve natyrore.

(2) Nje ndryshim ne formen ne te cilen pasurite jane investuar, nuk e ndryshon karakterin e tyre si investime.

(3) "Te ardhura" kupton shumat e vjelura nga nje investim dhe perfshin ne vecanti, por jo ekskluzivisht, fitimin, interesin, fitimin e investuar, dividendet, privilegjet ose shperblimet.

(4) Te ardhurave, dhe ne rast riinvestimi, shumat e vjela prej riinvestimit, do tu jepet e njejta mbrojtje si edhe investimit ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje.

(5) "Investitor" kupton ne lidhje me secilen Pale Kontraktuese:

(a) Personat fizike qe kane qytetarine ose shtetesine e nje Pale Kontraktuese ne perputhje me ligjet e saj.

(b) Çdo entitet i krijuar ne perputhje dhe i njohur si nje person juridik sipas ligjit te asaj Pale Kontraktuese, te tilla si kompanite, firmat, shoqatat, institucionet e zhvillimit financiar, fondacionet ose entitete te ngjashme pavaresisht se pergjegjesite e tyre jane te kufizuara ose aktivitetet e tyre jane apo jo te drejtuara tek perfitimet.

(6) "Territor" kupton ne lidhje me secilen Pale Kontraktuese territorin duke perfshire dhe ujrat territoriale nen sovranitetuin e saj si dhe zonat eskluzeve detare mbi te cilat Palet Kontraktuese ushtrojne, ne perputhje me te drejten nderkombetare, te drejten e sovranitetit ose te juridiksionit.

N E N I 2

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Çdo Pale Kontraktuese pranon investimet nga investitorët e Pales tjeter Kontraktuese ne perputhje me legjislacionin e saj dhe praktikat administrative dhe nxit keto investime, duke perfshire dhe krijimin e lehtesirave per vendosjen e zyrave te perfaqesimit.

2. Investimet e investitoreve te cdo Pale Kontraktuese do te gezojne ne cdo kohe nje mbrojtje dhe siguri te plote ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Asnjera nga Palet Kontraktuese nuk do te demtoje ne asnje menyre, nepermjet masash te paaresyeshme ose diskriminuese drejtimin, mirembajtjen, perdorimin, gezimin ose disponimin e investimit ne territorin e tij, te investitorit te Pales tjeter Kontraktuese.

3. Çdo Pale Kontraktuese do të respektojë çdo detyrim që mund të jetë ndërmarrë në lidhje me investimet e investitoreve të Pales tjetër Kontraktuese.

N E N I 3

Trajtimi i investimeve

1. Çdo Pale Kontraktuese do të akordojë në territorin e saj, investimeve të bera nga investitorët e Pales tjetër Kontraktuese, një trajtim të drejtë dhe të barabartë, i cili në çdo rast nuk do të jetë më pak i favorshëm se sa ai që ju akordon investitoreve të vet ose investitoreve të një shteti të tretë, çilido qoftë më i favorshmi nga pikpamja e investitorit.

2. Çdo Pale Kontraktuese do të akordojë në territorin e saj investitoreve të Pales tjetër Kontraktuese, në lidhje me drejtimin, mirembajtjen, përdorimin, gezimin ose disponimin e investimeve një trajtim të drejtë dhe të barabartë, i cili në çdo rast nuk do të jetë më pak i favorshëm se sa ai që ju akordon investitoreve të vet ose investitoreve të një shteti të tretë, çilido prej këtyre standarteve është më i favorshëm nga pikpamja e investitorit.

N E N I 4

Perjashtime

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me dhenien e trajtimit jo më pak të favorshëm se ai që i akordohet investitoreve të secilës Pale Kontraktuese ose të ndonjë Shteti të tretë nuk do të interpretohet si një detyrim për një Pale Kontraktuese që të shtrijë tek investitorët e një Pale tjetër Kontraktuese përfitimet e çdo traktati, preference ose privilegji që rezultojnë prej:

(a) anëtarësimit në ndonjë Organizatë të Integritetit Ekonomik Rajonal ekzistojnë ose që do të krijohet në të ardhmen, ose